

Nr. D-24408 / prot.  
2Tiranë, më 20/01 / 2026

Lënda: Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA ✓

Bulevardi "Gjergj Fishta", ndërtesa 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Dorian Matlija,

Pranë Bashkisë Tiranë, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. D-24408, datë 24.12.2025 dhe ka kaluar për shqyrtim pranë Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licencimit, e cila ka kthyer përgjigje nëpërmjet Drejtorisë së Programeve Sociale dhe Monitorimit të Strehimit me shkresën nr. prot. D-24408/1, datë 07.01.2026 si më poshtë:

"Përsa i përket individëve/familjeve që kanë aplikuar për të përfituar nga programet sociale të strehimit për vitin 2025, janë si më poshtë:

1. Programi i Subvencionimit të Qirasë: 570 individ/familje aplikues - 344 individ/familje përfitues.
2. Programi i Subvencionimit të Interesave të Kredisë: Thirrja për aplikime për këtë program ka filluar më datë 12.12.2024 dhe ka përfunduar në datën 13.01.2025.

Gjatë kësaj thirrje u shpallën fitues të fazës së parë 2337 individë/familje. Më pas u vijua me shpalljen e përfituesve të fazës së dytë, përkatësisht 1231 individë/familje sipas kriterëve të parashikuara në aktet ligjore".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Eldi Hoxha



